

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#86

Dita e Flamurit

*është kujtimi i kurajës kombëtare që tejkaloi një brez!
Nën hijen e flamurit kombëtar ata që prodhuan kohë,
Gjergj Kastrioti Skënderbeu,
Ismail Qemali,
Isa Buletini dhe të tjerët na ftojnë ta shohim të ardhmen me "sytë" e tyre!*



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Fillon trajnimi i strukturave administrative për diasporën dhe migracionin në bashkitë e vendit



Nëpërmjet një aktiviteti online projekti më i ri për angazhimin Diasporës në vendlindje. Ai do të jetë programi "Migrim & Diasporë", për angazhimin në vendlindje. Ky program që ka synim fuqizimin e rolit të diasporës dhe migrantëve në zhvillimin ekonomik vendor në Shqipëri është një projekt i financuar nga Qeveria Gjermane, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën e Shqipërisë, Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Ky projekt në fazën e parë të sapo nisur do të trajnojë strukturat administrative përgjegjëse për diasporën dhe migracionin të sapo krijuara në bashkitë e vendit pas ndryshimit të ligjit për pushtetin lokal. Gjatë këtij aktiviteti ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko shprehu interesin në këtë bashkëpunim të filluar me partnerët gjermanë ku përfuturit kryesor do të jenë bashkitë vendore, tek të cilat do të krijohen për herë të parë shërbimet ndaj diasporës dhe migracionit shqiptar.



Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës

është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë

rrjetiprofesionisteve.al

Botohet Periodiku i dytë për vitin 2020, "Diaspora Shqiptare", Analiza dhe Studime



Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës realizoi botimin Periodikut të dytë për vitin 2020, "Diaspora Shqiptare", Analiza dhe Studime. Ai publikohet çdo gjashtë muaj. Periodiku i dytë për vitin 2020, "Diaspora Shqiptare" ka në përmbajtje studime, raporte, artikuj dhe opinione falë kontributit të studiuesve e shkencëtarëve shqiptarë në Diasporë dhe Shqipëri. Në fokus të këtij Periodiku është Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 – 2025, e cila përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e komuniteteve shqiptare, të cilët jetojnë në vendet pritëse në mënyrë të ligjshme. Periodiku i dytë për vitin 2020, "Diaspora Shqiptare" shkrime të cilat janë kryer nga institucione shqiptare dhe ndërkombëtare me veprimtari brenda dhe jashtë vendit me fokus migracionin shqiptar.



Digjitalizimi

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

adld.al

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) organizon veprimtarinë e radhës, me temë: "Arbërit e Jonit"



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) ka organizuar sot, me datë 23 nëntor, ora 11.00 veprimtarinë e radhës, me temë: "Arbërit e Jonit- Bisedë me Akademikun Pëllumb Xhufi, në kuadër të festës së 28 Nëntorit". Në qendër të këtij bashkëbisedimi online të mbajtur nga profesori dhe historiani i mirënjohur Pëllumb Xhufi, u fol mbi librin e tij të fundit, të ribotuar me plotësime "Arbërit e Jonit", një libër që vetë autori e ka konsideruar projektin e jetës. Në takim merrnin pjesë drejtoresha ekzekutive e QSPA-së, Prof. Diana Kastrati së bashku me stafin e studiuesve të kësaj qendre. Pas përshëndetjeve të rastit, drejtoresha ekzekutive e QSPA-së prof. Diana Kastrati përmendi disa nga kontributet kryesore të karrierës akademike të prof. Pëllumb Xhufit, duke u ndalur në librin "Arbërit e Jonit", i cili përfaqëson një gur miliar jo vetëm në korpusin studimor të këtij autori, por edhe në studimet albanologjike në përgjithësi, pasi ndriçon periudhën e mesjetës, një nga periudhat më të pastuduara të historisë. Pyetja e parë që iu drejtua prof. Xhufit, kishte të bënte pikërisht me datimin fillestar të idesë së këtij projekti madhor.


Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)



"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)